

PËRMBAJTJA

<i>-Hyrje.....</i>	<i>2.</i>
<i>-Raporti i monitorimit të buxhetit të INSTAT-it 4 mujori i I i vitit 2020.....</i>	<i>2-3.</i>
<i>-Analiza e realizimit të buxhetit të INSTAT-it 4 mujori i I i vitit 2020.....</i>	<i>4-9.</i>
<i>-Aneksi Nr 1-Raporti i shpenzimeve sipas Programeve.....</i>	<i>10.</i>
<i>-Aneksi Nr 2-Raporti i shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë</i>	<i>11.</i>
<i>-Aneksi Nr 3-Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit</i>	<i>12.</i>
<i>-Aneksi Nr 4-Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit</i>	<i>13.</i>
<i>-Aneksi Nr 5-Projektet e investimeve me financim të brëndshëm dhe të huaj.....</i>	<i>14.</i>

HYRJE

Monitorimi i buxhetit të katërmujorit të parë të vitit 2020 për INSTAT-in përfaqëson procesin e vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore, nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuar. Strukturat e INSTAT-it kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetorë me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar dhe të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit të INSTAT-it të përfshirë në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të INSTAT-it të detajuar në nivel kategori shpenzimi buxhetor, nëpërmjet treguesve të planifikuar, duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

PROGRAMI 01320 “VEPRIMTARIA STATISTIKORE”

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtaria statistikore e INSTAT-it”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit të hartuar gjatë procesit të PBA 2020-2022 dhe është në funksion të realizimit të Politikës së Programit.

INSTAT, mbështetur në Ligjin Nr.17, datë 05.04.2018 “Për Statistikat Zyrtare” është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Misioni i tij është të prodhojë statistika asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Programi i Statistikave Zyrtare, 2017-2021, përcakton strategjinë e zhvillimit të statistikave zyrtare dhe Sistemit Kombëtar Statistikor, duke synuar përmbushjen e kërkesave të përdoruesve për statistika cilësore. Programi përmban aktivitetet statistikore, të cilat janë në funksion të zbatimit të strategjisë dhe prioritetëve të institucionit.

Politika e këtij programi konsiston në prodhimin e të dhënave statistikore të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë, duke u përqëndruar në fenomene thelbësore për vendimmarrësit, si dhe duke respektuar të drejtën e qytetarëve për të dhëna zyrtare, në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit të Institucionit, nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve menaxhuese në implementimin e objektivave që bëjnë të mundur përmbushjen e standardeve të vendosura nga BE, në garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare të INSTAT-it.

Politika e këtij institucioni është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

1. Prodhimi dhe shpërndarja në kohë e me cilësi e të dhënave statistikore në fushat ekonomike, sociale, të zhvillimit demografik dhe mjedisor në nivel qendror dhe lokal.
2. Përdorimi i burimeve të të dhënave dhe instrumenteve të duhura, për të përmirësuar prodhimin dhe cilësinë e treguesve dhe shërbimeve statistikore.
3. Përmirësimi profesional dhe organizativ i Sistemit Kombëtar Statistikor.
4. Zhvillimi i sistemeve inovative ITC për përpunimin statistikor, shkëmbimin e të dhënave dhe komunikimin.

Menaxhimi i buxhetit është i fokusuar në financimin e shpenzimeve në funksion të përmbushjes së objektivave prioritare strategjike të mëposhtme:

- *Përmirësimin e cilësisë së realizimit të vrojtimeve, duke përdorur teknika moderne për grumbullimin e përpunimin e të dhënave, si dhe duke rritur kapacitetin profesional të punonjësve mbështetës nëpërmjet trajnimeve.*
- *Zgjerimin e fushës së mbulimit me aktivitete të reja sipas kërkesave të përdoruesve dhe të rrisë numrin e njësive statistikore (njësi ekonomike dhe familje) të intervistuar në vrojtimet statistikore.*
- *Paraqitjen e një produkti statistikor të përmirësuar cilësor dhe sasior tek përdoruesit nëpërmjet publikimeve statistikore, zhvillimit të konferencave, interpretimit të tyre me mjete të ndryshme komunikimi.*
- *Mirëmenaxhimin e institucionit, duke aplikuar një menaxhim të lartë administrativ të burimeve financiare dhe njerëzore.*
- *Përditësimin e infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të përpunimit të të dhënave.*
- *Pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale dhe kompjuterike për përpunimin e të dhënave, si dhe të krijohen kushte të përshtatshme pune për punonjësit nëpërmjet mobilimit të zyrave.*

**“RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE TË PROGRAMIT SIPAS ARTIKUJVE
PËR 4/MUJORIN 2020”**


Buxheti i Institutit të Statistikave për vitin 2020, i miratuar me ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar është 1,007,500 mijë lekë.

Këto fonde, INSTAT i administron në një program “Veprimtaria Statistikore”, si më poshtë :

Mijë /lekë

Artikulli Kodi	Emërtimi i artikullit	Buxheti Fillestar vjetor 2020	Buxheti Rishikuar vjetor 2020	Fakti 4/mujore	% e Realizimit Plan/Fakt Vjetore
6000000	Pagat	616,870	444,870	110,520.7	24.8
6010000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	102,996	77,996	20,696.3	26.5
6020000	Mallra dhe shërbime	217,560	88,560	9,117.6	10.3
6040000	Transferta korrente të brendshme	1,574	1,574	96.6	6.1
6060000	Transferta buxhetesh familjare	0	500	270.3	54.1
2310000	Investime	394,000	394,000	14,876.6	3.8
	Të ardhura jashtë limitit	0	0	8,205.7	0
	TOTALI	1,333,000	1,007,500	163,783.8	16.3

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, të planifikuara mbi totalin e shpenzimeve paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Siç shihet nga tabela, zëri paga dhe sigurime shoqërore e shëndetsore zë 52 % të buxhetit, zëri mallra dhe shërbime zë 9% , ndërsa zëri investime zë 39 % të buxhetit.

Për vitin 2020 ishte planifikuar të kryhet CENS-i Popullsisë dhe Banesave 2020, por për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 nuk do të kryhet, gjë që çoi në ndryshimin e buxhetit fillestar.

ANALIZA E REALIZIMIT TË BUXHETIT TË INSTAT-it PËR 4-MUJORIN E I-rë **TË VITIT 2020**

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave për katërmujorin e vitit 2020, krahasuar me planin 4/mujor paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Veprimtaria statistikore		Mijë lekë			
Artikulli Kodi	Emërtimi i artikullit	PLANI VJETOR RISHIKUAR	PLANI 4/mujor	FAKTI 4/mujor	% Realizimit 4/mujor
6000000	Paga+sigurime	522,866.0	156,106.0	131,217	84.1
6020000	Mallra dhe shërbime	88,560.0	64,017.0	9,117.6	14.2
6040000	Transferta korrente të brëndshme	1,574.0	1574.0	96.6	6.1
6060000	Transferta për buxhete familjare	500.0	500	270.3	54.1
	Shuma shpenzimeve operative	613,500.0	222,197.0	140,701.5	63.3
2310000	Investime	94,000.0	94,000.0	1,864.6	2.0
2310000	Financim i huaj	300,000.0	300,000.0	13,012.0	4.3
	Të ardhura jashtë limitit	0	0	8,205.7	0.0
	TOTALI	1,007,500.0	616,197.0	163,783.8	26.6

1- Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore. Llogaria 600-601

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 për zërin paga dhe sigurime është 522,866 mijë lekë, nga të cilat janë shpenzuar 131,217 mijë lekë, ose 84.1% e planit 4/mujor 2020.

Shuma e shpenzuar në zërin paga dhe sigurime përfshin pagat e punonjësve të strukturës të INSTAT-it, si dhe pagat e punonjësve me kontratë të përkohshme pune, për organizimin dhe zhvillimin e anketave,

mbështetur në përlllogaritjen e numrit të punonjësve të domosdoshëm sipas pozicioneve, duke mbajtur parasysh kontributin e çdo pozicioni në secilën anketë .

Mos realizimi ka ardhur kryesisht nga mos plotësimi i 23 vendeve vakante të strukturës organike dhe shtyrja në afate e anketimeve, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19.

2- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera. Llogaria 602

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 për zërin Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera është 88,560 mijë lekë dhe janë shpenzuar 9,117.6 mijë lekë ose 14.2 % e planit 4/mujor.

Mos realizimi ka ardhur kryesisht nga mos zhvillimi procedurave të prokurimeve për shkak të Pandemisë së Covid-19.

3- Transferta korrente të brëndshme. Llogaria 604

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2020 për zërin Transferta korrente të brëndshme është 1,574 mijë lekë dhe nga këta janë shpenzuar 96.6 mijë leke, ose 6.1% e fondit.

4- Transferta për buxhete familjare. Llogaria 606

Gjatë periudhës janar-prill 2020 është shpenzuar fond i vecantë në vlerën 270.3 mijë lekë, ose 54.1 % e fondit për daljen e punonjësve në pension, për raste fatkeqësie dhe sëmundjeje.

5- Shpenzime për Investime Kapitale. Llogaria 231

Bazuar në ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është në shumën 394,000 mijë lekë, nga të cilat 94,000 mijë lekë për Investime me Financim të Brënshtëm dhe 300,000 mijë lekë për Investime me Financim të Huaj.

Realimi i Investimeve me Financim të Brënshtëm është 1,864.6 mijë lekë, dhe realizimi i Investimeve me Financim të Huaj është 13,012 mijë lekë.

6- Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit

Shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit për 4/mujorin e I-rë të vitit 2020 janë 8,205.7 mijë lekë.

Gjatë periudhës janar-prill 2020 janë likujduar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve sipas faturave dhe afateve ligjore. INSTAT-i nuk ka detyrime të prapambetura.

Realizimi i shpenzimeve sipas produkteve për periudhën katërmujore paraqitet si më poshtë :

Mijë lekë					
Llogaria Ekonomike	Produkti	Output Code	PLAN	FAKT 4/mujor	% Realizimit
6000000	Njësi statistikore të vrojtuar	95001AA	199,860	47,527.5	24
6010000		95001AA	36,160	10,222.2	28
6020000		95001AA	16,108	2,922.5	18
6020000	Të dhëna statistikore të publikuara	95001AB	3920	0	0
6000000	Personel i trajnuar	95001AC	245,010	62,993.3	26
6010000		95001AC	41,836	10,474.0	25
6020000		95001AC	68,362	6,195.1	9
6060000		95001AC	500	270.3	54
6040000		95001AC	1,574	96.6	6
6020000	Auditime të kryera.	95001AD	170	0	0
2310000	Infrastrukturë e nevojshme software- të përditësuara	M500011	3,260	0	0
2310000	Pajisje të teknologjisë së informacionit të blera	M500002	82,770	0	0
2310000	TVSH	M500005	6,230	1,864.6	30
2310000	Blerje paisje Zyre	M500006	1,740	0	0
2310000	Financim I Huaj	GM50002	300,000	13,012.0	4
	Te ardhura jashtë limitit		0	8,205.7	0
6020000	TOTALI	95001AC	1,007,500	163,783.8	16.3

Për programin e veprimtarisë statistikore për katërmujorin e I-rë të vitit 2020 janë shpenzuar nga fondet e buxhetit të shtetit 142,566.1 mijë lekë, ose 20.4 % ndaj planit vjetor, shpenzimet nga financimi i huaj janë 13,012 mijë lekë, si dhe shpenzimet nga të ardhurat jashtë limitit janë 8,205.7 mijë lekë.

Në total për katërmujorin e I-rë të vitit 2020 janë shpenzuar 163,783.8 mijë lekë.

Mijë lekë

				% Realizimit
	SHPENZIMET	Plani	Fakti 4/mujor	
	Veprimtaria Statistikore	707,500.0	142,566.1	20.4 %
	Financim i Huaj	300,000.0	13,012.0	4.3 %
	Te ardhura jashtë limitit	0	8,205.7	
	TOTALI	1,007,500.0	163,783.8	16.3 %


Realizimi i shpenzimeve operative, sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Veprimtaria statistikore

Mijë /lekë

Art	SHPENZIMET	VITI	2020	Fakti	% e Realizimit Plan/Fakt 4 mujor
		PLANI	PLANI 4/mujor		
600	Paga+sigurime shoq e shendetsore	522,866.0	156,106.0	131,217.0	84.1
602	Mallra dhe sherbime te tjera	90,634.0	66,091.0	9,484.5	14.4
	Te ardhura jashtë limitit	0.0	0.0	8205.7	0.0
	TOTALI OPERATIVE	613,500.0	222,197.0	148,907.2	67.0

Pesha specifike sipas zërave të shpenzimeve, mbi totalin e tyre paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm:



Gjatë periudhës Janar – Prill 2020, Sektori i Prokurimeve ka zhvilluar gjithsej 27 procedura prokurimi, si më poshtë:

- 10 procedura “Prokurim me vlerë të vogël”
- 3 procedura “Sistem dinamik i blerjes së biletave të transportit ajror”
- 4 procedura “Blerje nën 100.000 lekë, pa tvsh”
- 2 procedura prokurimi “Emergjente”
- 3 procedura prokurimi “Kërkesë për propozim”
- 5 procedura prokurimi të realizuara nga fondet e donatorëve:

Nga procedurat e prokurimit të mësipërme janë anuluar gjithësej 4 procedura prokurimi, si më poshtë:

- Shërbim larje automjesh (Nr. 03, dt. 04.02.2020) (Anulluar);
- Sigurim i detyrueshëm TPL për automjetin Hyundai Tucson me targë TR5258N (Nr. 05, dt. 05.02.2020) (Anulluar);
- Shërbim larje automjesh (Nr. 06, dt. 12.02.2020) (Anulluar);
- Sigurim i detyrueshëm TPL për automjetin Ford Everest me targë TR3492T (Nr. 13, dt. 10.03.2020) (Anulluar);

Në zbatim të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2371 Prot., datë 31.03.2020 për pezullimin e shpalljes së procedurave të reja të prokurimit publik, si dhe atyre që janë në proces, për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, gjatë muajit Prill 2020, Autoriteti Kontraktor ka pezulluar të gjitha procedurat e prokurimit që kanë pasur si afat shpalljen në këtë periudhë, me përjashtim të atyre procedurave që janë konsideruar emergjente dhe që ndikojnë drejtpërdrejtë në funksionimin e institucionit.

Realizimi në sasi sipas produkteve për periudhën katërmujore paraqitet si më poshtë :

Nr	Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Plan	Fakt	% Real
1	Njësi statistikore të anketuara	249,616	67,942	27
2	Të dhëna të publikuara	55	25	45
3	Personel i trajnuar	236	213	90
4	Auditime të kryera	9	1	11
5	Blerje Liçensa	10	0	0
6	Blerje paisje kompjuterike	2,740	0	0
7	Blerje Paisje Zyre	14	0	0

Katër tregues të Performancë/Produktit për periudhën katërmujore krahasuar me planin 4/mujor janë realizuar në masën 100%.

ZËVËNDËS KRYETAR I BORDIT DREJTUES

Elsa DHULI